



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË**

**UDHËZIM**

**Nr. 52, datë 3.12.2015**

*Azhornuar me udhëzimin nr. 5, datë 16.02.2017,  
Udhëzimin nr. 11, datë 10.04.2017,  
Udhëzimin nr. 20, datë 22.09.2017*

**PËR  
PËRCAKTIMIN E NIVELEVE TË GJUHËVE TË HUAJA DHE TË TESTEVE  
NDËRKOMBËTARE, PËR PRANIMET NË PROGRAMET E STUDIMIT TË  
CIKLIT TË DYTË DHE TË TRETË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË**

Në mbështetje pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 4, të nenit 76 dhe pikës 3, të nenit 78, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

**UDHËZOJ:**

1. Përcaktimin e niveleve dhe testeve ndërkombëtare të 5 (pesë) gjuhëve të huaja, përkatësisht: gjuhës angleze, gjuhës frënge, gjuhës gjermane, gjuhës italiane dhe gjuhës spanjolle. Kandidatët, të cilët aplikojnë për t'u pranuar në programe studimi të ciklit të dytë apo të tretë në institucionet e arsimit të lartë, duhet të kenë nivel të njohjes së njërës prej gjuhëve të huaja, sipas përcaktimeve në këtë udhëzim.
2. Klasifikimi i aftësive gjuhësore dhe niveleve të njohjes së gjuhëve, bëhet sipas tabelës bashkëlidhur këtij udhëzimi në referencë të pikëve të testeve të ndryshme ndërkombëtare dhe shërben si standard për njohjen e gjuhëve të huaja dhe testeve ndërkombëtare përkatëse në Shqipëri.
3. Për pranimin në programet e studimit të ciklit të dytë kandidati duhet të ketë njohje të gjuhës së huaj, ndërmjet nivelit B1 dhe nivelit C1. Institucionet e arsimit të lartë përcaktojnë në rregulloret e tyre nivelin e gjuhës, që do të jetë kriter hyrës në programet e studimit të ofruara prej tyre në ciklin e dytë, brenda niveleve të sipërcituara në këtë pikë të udhëzimit. Për pranimin në programin e studimeve të ciklit të tretë, kandidati duhet të ketë njohje të gjuhës së huaj, të nivelit C1.
4. Kandidati që aplikon për t'u pranuar në programe studimit të ciklit të dytë apo të tretë në institucionin e arsimit të lartë, duhet të ketë certifikime dhe rezultate të testeve ndërkombëtare për nivelet e njohjes së gjuhëve, brenda afateve të vlefshmërisë së certifikimeve të lëshuara.
5. Dokumenti i njohjes së gjuhëve, mund të jetë një certifikatë, diplomë apo dëshmi, e lëshuar nga subjekte të njohura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, për ofrimin e testeve ndërkombëtare.

6. Institucionet e arsimit të lartë duhet të shpallin në faqen zyrtare dhe ambientet e tyre:

a) Listën e niveleve të njohjes së gjuhëve të huaja dhe testeve ndërkombëtare në referencë të përcaktimeve të tabelës 1, bashkëngjitur këtij udhëzimi, të përcaktuar si kriter pranimi në programet e studimit të ciklit të dytë apo të tretë në atë institucion;

b) Listën e subjekteve të njohura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, që gëzojnë të drejtën e pronësisë intelektuale mbi testimet ndërkombëtare.

7. Institucionet e arsimit të lartë duhet të garantojnë akses dhe mundësi të barabarta për të gjitha subjektet që gëzojnë të drejtën e pronësisë intelektuale mbi testimet ndërkombëtare dhe certifikimin të njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

8. Institucionet e arsimit të lartë, përcaktojnë në rregulloret e tyre, modalitetet e dorëzimit dhe verifikimit të certifikimit të nivelit të njohjes së gjuhës së huaj, në përputhje me procedurat e tjera të pranimit të kandidatit në programet e studimit të ciklit të dytë apo të tretë.

9. Subjektet që gëzojnë të drejtën e pronësisë intelektuale për ofrimin e testeve ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, certifikimet e të cilëve do të shërbejnë në përmbushjen e detyrimit ligjor, duhet të:

a) Paraqesin në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, dokumentacionin ligjor për të drejtën e pronësisë intelektuale dhe ofrimin e testeve ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, sipas procedurave dhe afateve kohore të publikuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;

b) Nënshkruajnë marrëveshjen me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, me qëllim njohjen e të drejtës së subjektit për ofrimin e testeve, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi, shkëmbimin e informacionit në lidhje me testimet ndërkombëtare, si dhe ofrimin e të dhënave për të gjithë kandidatët që aplikojnë në institucionet e arsimit të lartë për programet e studimit të ciklit të dytë apo të tretë.

10. Subjektet që ofrojnë kurse përgatitore, për prodhimin ose/dhe shpërndarjen e teksteve didaktike të gjuhëve të huaja, nuk mund të jenë ofruese të shërbimit të testeve dhe certifikimeve ndërkombëtare.

11. Studentët e regjistruar në ciklin e dytë apo të tretë të studimeve në institucionet e arsimit të lartë, të cilët nuk i janë nënshtruar testimit të gjuhës angleze, si dhe nuk kanë paraqitur dokumentacion pranë institucioneve të arsimit të lartë, sipas udhëzimit nr. 14, datë 28.3.2011, "Për njohjen e testeve dhe certifikimeve për gjuhën angleze për programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë në institucionet e arsimit të lartë", kryejnë testimin sipas këtij udhëzimi.

12. Udhëzimi i ministrit të MASH-it nr. 14, datë 28.3.2011, "Për njohjen e testeve dhe certifikimeve për gjuhën angleze për programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë në institucionet e arsimit të lartë", shfuqizohet.

13. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtorja e Shërbimeve Juridike në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, si dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**LINDITA NIKOLLA**

**MINISTËR**

Tabela 1/2

Në mbështetje të Kuadrit të Referencave për Gjuhët të krijuar nga Këshilli i Europës (2001), Kuadrit të Përbashkët European të Referencave për Gjuhët, si dhe në bashkëpunim me Ambasadat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Britanisë së Madhe, Gjermanisë, Francës, Italisë dhe Spanjës të akredituara në Republikën e Shqipërisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, njih testet e gjuhëve të huaja dhe nivelet si më poshtë:

<b>Niveli</b>	<b>B1</b>	<b>B2</b>	<b>C1</b>
<i>Gjuha angleze</i>			
<b>Cambridge</b>	<b>PET</b>	<b>FCE</b>	<b>CAE</b>
<b>IELTS</b>	<b>4.0 / 5.0</b>	<b>5.5 / 6.0</b>	<b>6.5 / 7.0</b>
<b>TOEFL Internet-based Test (iBT)</b>	<b>57/86</b>	<b>87/109</b>	<b>110/120</b>
<b>TOEFL Paper-based Test (ITP)</b>	<b>460</b>	<b>543</b>	<b>627</b>
<b>TOEIC</b>	<b>381 / 649</b>	<b>650/ 785</b>	<b>786 / 935</b>
<b>GESE</b>	<b>-</b>	<b>7, 8, 9</b>	<b>10, 11</b>
<b>APTIS</b>	<b>Aptis B1</b>	<b>Aptis B2</b>	<b>Aptis C</b>
<i>Gjuha gjermane</i>			
<b>Goethe-Institut, Goethe Zentrum</b>	<b>Goethe-Zertifikat B1</b>	<b>Goethe-Zertifikat B2</b>	<b>Goethe-Zertifikat C1</b>
<b>TestDaF</b>	<b>-</b>	<b>TDN 3 - TDN4</b>	<b>TDN 5</b>
<b>OSD</b>	<b>OSD-Zertifikat B1</b>	<b>OSD-Zertifikat B2</b>	<b>OSD-Zertifikat C1</b>
<i>Gjuha franceze</i>			
<b>TFI</b>	<b>345/604</b>	<b>605/824</b>	<b>825</b>
<b>DELFB</b>	<b>DELF B1</b>	<b>DELF B2</b>	<b>DALFC1</b>
<b>TCF</b>	<b>TCF 300 - 399</b>	<b>TCF 400 - 499</b>	<b>TCF 500 - 599</b>
<b>TEF</b>	<b>TEF 361-540</b>	<b>TEF 541-698</b>	<b>TEF 699-833</b>
<i>Gjuha italiane</i>			
<b>Peruggia</b>	<b>CELI2 livello2</b>	<b>CELI3 livello3</b>	<b>CELI4 livello4</b>
<b>Sienna</b>	<b>CILS uno B1</b>	<b>CILS 2</b>	<b>CILS 3</b>
<b>PLIDA</b>	<b>PLIDA certification B1</b>	<b>PLIDA certification B2</b>	<b>PLIDA certification C1</b>
<i>Gjuha spanjolle</i>			
<b>DELE</b>	<b>DELE inicial</b>	<b>DELE intermedio</b>	<b>DELE superior</b>